



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:051552
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05621431

AA.nr.414/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit, Agjencia Kosovare e Privatizimit/Autoriteti i Likuidimit i Ndërmarrjes Shoqërore “K.....”, kundër të paditurit-kundër propozuesit, Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës dhe ankesën e palës së interesit O. K., të cilën e përfaqëson Sh.S., avokat në L., të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.431/2024, të datës 26.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e të paditurës-kundër propozueses Agjencia Kadastrale e Kosovës, e datës 18.03.2024, dhe ankesa e palës së interesit O.K., e datës 14.03.2024, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1305/2021, i datës 08.07.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktvendimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Aprovohet propozimi i paditësit- propozuesit Agjencia Kosovare e Privatizimit/ Autoriteti i Likuidimit i Ndërmarrjes Shoqërore “K.....”, si i bazuar. Në pikën II. Shtyhet ekzekutimi i Vendimit të paditures Agjencia Kadastrale e Kosovës nr. 03/1613/20 i datës 18.05.2022, deri sa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor, përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditura, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, dhe

aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të miratohet ankesa e AKK në tërësi si e bazuar, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1305/2021, i datës 08.07.2021, hudhet poshtë padia dhe propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ e paditësit si e pasafatshme.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë i autorizuari i palës së interesit, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj në tërësi të bazuar ankesën dhe në kuptim të dispozitave të LPK-së ta anuloj Aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë A.nr.1305/2021, i datës 08.07.2021 dhe ta hedhë poshtë si të pasafatshme kërkesën për pezullim vendimi apo ta refuzoj kërkesën e paditësit si të pa bazuar apo çështjen ta kthej në ri procedurë dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesat janë të **pabazuara**.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, ka aprovuar kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se Gjykata vlerësoi se në rastin konkret plotësohen kushtet nga neni 22 të LKA-së, përkatësisht ka konstatuar se ekzekutimi i vendimit në fjalë paditësit do të shkaktonte dëm të riparueshëm. Duke u nisur nga propozimi i palës paditëse-propozuesi me të cilin ka theksuar se vendimi administrativ i atakuar me këtë padi do të ekzekutohen, kjo do t'i sillte paditësit pasiguri juridike gjatë tërë procedurës së likuidimit të ndërmarrjes shoqërore "KB Kosova" Prishtinë. Këto dëme Autoriteti i Likuidimit nuk do të mund të riparonte dhe për më tepër kjo do të ndikonte në mënyrë direkte edhe në ushtrimin e autorizimeve ligjore të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të të përcaktuara sipas dispozitave ligjore nga neni 28, 43 dhe 44 të Shtojcës së Ligjit për AKP (Ligji Nr. 04/L-034) si dhe neni 5.1.1.7 dhe neni 5.1.1.10, të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligji Nr. 06/L-086). Më tej ka theksuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit administrativ të atakuar me padi, nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe nuk do të i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Nga kjo rrjedh fakti se nga ky propozim dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se ekzekutimi i vendimit i marr nga pala e paditur mund të krijohen pasoja me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e palës paditëse-propozuesit.

Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe duke shqyrtuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, gjykata vlerësoi se paditësi ka ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm paditësit i cili dëm vështirë do të riparohej. Gjithashtu gjykata gjeti se shtyrja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare.

Meqenëse funksionimi i rregullt i institucioneve, përbën interes të përgjithshëm, rrjedhimisht, gjykata vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen lidhur me padinë e paditësit, është në interes publik e që shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar. Kjo shmang pasojat e mundshme që do të

shkaktoheshin në të ardhmen, nëse vendimi i kundërshtuar i të paditurës, në fund të procesit gjyqësor, rezulton se është marrë në kundërshtim me ligjin.

Aprovimi i kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk paraqet çështje të (gjykuar) dhe të përfunduar, ngase me aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nuk prejudikohet vendosja e çështjes kryesore sipas padisë së paditësit/propozuesit për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrativ-vendimit të kontestuar, të cilin kjo Gjykatë do ta trajtoj dhe do ti japë epilog ligjor brenda afatit të arsyeshem.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës nr. ... i datës ..., deri sa gjykata të vendosë me vendim përfundimtar gjyqësor, përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se me ekzekutimin e vendimit të kontestuar propozuesit, do t'i sillte dëm të konsiderueshem dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk i shkakton dëme palës kundërshtare dhe personave të interesuar.

Pretendimi i paditësit në ankesë se gjykata e shkallës së parë ka shkelur nenin 305, paragrafi 2 të LPK-së, këtë pretendim kolegji i apelit e refuzoj si të pa bazuar për faktin se paditësi fletë kthesën për dorëzim me post e ka pranuar me datë 20.02.2024, ndërsa përgjigjen sipas njoftimit e ka dorëzuar në gjykatë me datë 06.03.2024, që i bie jashtë afatit ligjor prej 7 ditësh.

Kolegji i Apelit, njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se paditësi ka dëshmuar me prova se me ekzekutimin e vendimit kontestues nr. ... i datës ..., do mund ti sillte dëme të pariparueshme paditësit.

Pretendimet ankimore të palës së paditur, dhe palës së interesit të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe as me konstatim të gabuar të gjendjes faktike siç pretendon e paditura në ankesë sepse kolegji nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të vërtetonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshem, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës dhe se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit

me rastin e aprovimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast e paditura në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme me asnjë provë pretendimet e tij. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.414/2024, me datë 23.04.2024

Kryetare e Kolegjit,
Delushe Halimi